

Data 10.01.2024

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Vlerësimi teknik në instalimet e Gazsjellësit TAP”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44161100-7;
71321000-4; 71356000-8; 1356100-9; 71600000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 60,790,766 (gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh, ose 583,909 (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntë) Euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 10.01.2024 është 104.11 lekë/EURO.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit është si më poshtë:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues pas procesit të prokurimit, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka.

Përveç arsyeve të listuara më sipër, shërbimet e kerkuara në këtë procedurë janë pjesë e planit të mirmbajtjes së TAP. Ky plan vjen i pa ndare e për rrjedhojë edhe procedura e prokurimit duhet të jete e tille. Gjithashtu, cdo punonjes i Operatorit Ekonomik që do të shpallet fitues do duhet të marrë trajnimet e nevojshme të sigurojë dhe shëndetit në punë dhe të behen të ditura rreziqet e impjanteve ku do të zhvillohet aktiviteti. Këto trajnime do të zhvillohen nga Autoriteti Kontraktor i cili me pas ngarkon profilin e cdo punonjesi të Operatorit Ekonomik në sistemin elektronik të kualifikimit të TAP (Agora).

Për ndarjen në lote dhe në shumë operatore ekonomik i kësaj procedurë do të rriste numrin e personave të cilët aksesojnë impiantet e TAP cka mund të çojë në rrisje të rrezikut të ekspozimit të personelit ndaj rrisqeve të impianteve të transmetimit të gazit në presionit të lartë.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm.

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. *Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve...*

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave, marjen e autorizimeve nga TAP për cdo operator ekonomik dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës ndaj vlerësojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me ligjin e sipërpërmendur.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose loti, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Kjo procedurë është është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit të limit të Marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 40 % të fondit limit të MK, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001:2018, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të detektimit, sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Duke qenë se, shërbimet mirëmbajtjes së sistemit të detektimit, sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri të parashikuara në këtë kontratë do të realizohen në terren përgjatë shtrirjes së taubacionit të gazit TAP, ku ushtron aktivitet AGS sh.a, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ta disponojnë edhe Standartin ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit”. Kjo ISO është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë manaxhimi i duhur i ceshtjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda me e thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi manaxhimi për mjedisin në

konformitet me parashikimet e standartit nderkombetar ISO14001. Perfitimet kryesore per kete sistem manaxhimi jane: paraqitja e angazhimit per mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potenciale, komuniteti, autoritetet; zvogelimin e shpenzimeve nepermjet permiresimit te administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit te burimeve; parandalimin e incidenteve te mundshme qe mund te coje ne pagesen per demshperblim dhe deme; permiresimin e marredhenieve me autoritetet; mundesi per hyrje ne tregje te reja. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Standarti ISO 45001:2018 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj. Për më tepër, që në kriteret teknike AK ka kërkuar ndër të tjera që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të caktuar, minimal prej 6 punonjës, të cilët duhet ti sigurojnë AK shërbimin e nevojshëm gjatë gjithë periudhës që do të shtrihet kontrata.

Në këtë kuptim, AK në vendosjen e kriterëve të mësipërme kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre. Në objektin e kontratës janë parashikuar shërbime, të cilat rrezikojnë në mënyrë të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjësve që do të angazhohen, kështu që rrjedhimisht kërkesa për këtë certifikatë është një kërkesë e nevojshme.

Gjithashtu argumentojmë se, politikat e AGSco Sh.A. per sigurinë dhe shëndetin ne pune kane nje rol thelbesor per te gjitha llojet e aktiviteve qe ushtrohen, kerkese kjo si kontraktuale ndërmjet nesh edhe TAP ashtu edhe ndërmjet nesh edhe te gjithë palëve te treta (sic janë operatorët ekonomike) qe lidhin kontratë me AGSco dhe do te kryejne aktivitet furnizimi, trajnimi dhe shërbimi.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë Certifikatën e Akreditimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (për të kryer inspektim sipas ISO/IEC 17020:2012 «Kritere të Përgjithshme për Funkionimin e Tipeve të Ndryshme të Organizmave që Kryejnë Inspektim » si një organizëm Inspektimi i Pavarur i Tipit A për fushat e inspektimit si më poshtë:

- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të enëve nën presion.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të valvulave të sigurisë të presionit
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të Instalimeve Elektrike
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të makinerive ngritëse dhe aksesorëve.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të shkallëve dhe platformave
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të instalimeve ATEX.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të ashensorëve.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të litereve së sigurisë per punimet ne lartesi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar zerave të shërbimeve dhe termave të referencës është e dëmd që OE të disponojnë këtë lloj certifikim për të kryer inspektimet me cilësi dhe sipas rregullave që kërkon legjislacioni i fuqeshë përkatës.

2.2.6 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike në pronësi ose qira sipas tabelës më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Pajisjet</i>	<i>Sasia</i>
1	Detektor gazi personal	2 copë
2	Multimeter digital për matjen e voltazhit DC, voltazhit AC, rrymes DC, Rezistencës, Kapacitorit, Frekuencës, Temperatures	2 copë
3	Kamer dixhitale termike 250°C	1 copë
4	Matës i rezistencës së veshjes (Megohmmetër) ($\geq 5000V$)	1 copë
5	Testues i Fushës Elektromagnetike	1 copë
6	Pajisje për matjen e rezistencës së tokës	2 copë
7	Kalibër Vernier	1 copë
8	Shirit matës	1 copë
9	NDT – Detektor difekti UT për inspektimin e saldimit dhe strukturës metalike për trashësi deri në 60 mm.	1 copë
10	NDT- UT pajisje për matjen e spesorit	1 copë
11	Tahometër për matjen e rrotullimeve (RPM) Gama e matjes $\geq 20,000$ RPM	1 copë
12	Matës presioni ≥ 200 bar	1 copë
13	Matës presioni dixhital ≥ 200 bar	1 copë
14	Termometër me kontakt. diapazon -20 °C +80 °C.	1 copë
15	Mates Spesori DFT diapazon deri në 30 mm	1 copë
16	Testues i fortësisë së bojës: Gama e matjes nga 0 deri në 80 Shore D	1 copë
17	Termometër ambientit Diapazoni i matjes: -10°C to +60°C	1 copë
18	Pajisje për matjen e Deë Point	1 copë
19	Pajisje për matjen e lagështisë relative. Diapazoni i matjes nga 5% deri në 60% RH	1 copë
20	Pajisje testuese për transformatorët, celes të automatizuar etj. Për matjen e:	1 copë

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

	<ul style="list-style-type: none"> - TanDelta ($tg\delta$), - Faktori i fuqisë ($\cos \varphi$) - Kapacitetet (C) - Transformatori TTR, CT, raporti VT) 	
21	Testi i analizës të pergjigjes së frekuencës (SFRA Test)	1 copë
22	Load Cell Kapaciteti i ngarkesës $\geq 20 T$ Çertifikuar ATEX	1 copë
23	Matës inspektues të saldimit (CAM Gauge)	1 copë
24	NDT- MPI Yoke për inspektimin e saldimit	1 copë
25	NDT- Gjenerator Rreze $X \geq 250 KV$)	1 copë
26	Dozimetër elektronik	1 copë
27	Matës i kontaminimit të kripës për inspektimin e procesit të bojës	1 copë
28	Coating-Dolly pulls off adhesion tester Measuring range 0-20 N/mm ²	1 copë
29	Detektor Coating-Holliday Testues voltazhi 5-25 kv Frekuence 25Hz	1 copë

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet këtij dokumentacioni:

- Për pajisjet, duhet të dorëzojë faturat e blerjes ose kontratën e qirasë si dhe fletën e të dhënave ku të specifikohen qarte të dhenat teknike të kerkuara në tabelë dhe për pajisjet nga zëri 1-20, duhet të dorëzojë një certifikatë të vlefshme kalibrimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kerkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Persa i perket paisjeve të kerkuara në tabelën e mesiperme argumentojmë për sa më poshtë vijon:

- Paisja Nr.1, Detektor gazi personal është një paisje e detyrueshme për tu përdorur nga personeli, i cili akseson ambientin me presencë gazi dhe atmosferat eksplozive. Është një paisje e detyrueshme për të ruajtur sigurinë e personelit, i cili do të operojë në impiantet e TAP.

- Grupi i paisjeve te listuara Nr.2 deri Nr.6 perdoren per inspektimet elektrike te pershkruara ne dokumentin bashklidhur “Specifikimet teknike”, kategoria A pika 3 “Inspektim periodik dhe vleresim konformiteti te instalimeve dhe Pajisjeve elektrike” .
- Grupi i paisjve te listuara Nr.7, 8 9 10, 23, 25, 26 do te perdoren per inspektimet NDT (kontrollat pa shkaterrim) te pershkruara ne dokumentin bashkelidhur “Specifikimet teknike”, kategoria B pika 3 “Testime pa shkaterrim i strukturave metalike dhe saldimeve (NDT)”.
- Paisjet Nr. 8, 11 12, 22 do te perdoren per vlersimet teknike te pershkruara ne kategorine A pika 4 “Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të makinerive ngritëse dhe aksesorëve”
- Grupi i paisjeve te Nr.14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe Nr. 27, 28, 29 do te perdoren per vlersime te gjendjes teknike dhe testime te veshjeve mbrojtese (bojes) ne strukturat metalike te preshkruar ne dokumentin bashkelidhur “Specifikimet teknike” kategoria B, pika 4.
- Paisjet Nr.20 dhe 21 do te nevojiten per Testimin e transformatoreve elektrik sipas kategorise A pika 3 te pershkruara ne dokumentin “Specifikimet teknike”.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimumi 6 (gjashtë), të cilët duhet të jenë 3 (tre) Inxhinierë Elektrikë, 3 Mekanikë, dhe duhet te jene te Certifikuar me kualifikimet si më poshtë:

- 1 (një) inspektorë të certifikuar NDT për RT/PT/MT/VT/UT – Niveli II
- 1 (një) personel i certifikuar për siguri nga rrezatimi
- 1 (një) personel i certifikuar për inspektimin termografik
- 2 (dy) personel të certifikuar për inspektimin ATEX
- 1 (një) person pergjegjes /koordinator HSE

*Shënim**

Inspektori NDT duhet të jetë i kualifikuar dhe certifikuar sipas SSHEN-ISO 9712.

Inspektori termografik duhet të jetë i certifikuar sipas ISO18436-7:2014

Inspektori ATEX duhet të jetë i certifikuar sipas SSH EN 60079.

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorezimit te këtij dokumentacioni:

- i. Për të plotësuar këtë kriter, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë pagesat e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.*
- ii. Për inspektorin NDT, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, certifikatën e kualifikimit dhe CV përkatëse.*
- iii. Për inxhinierët, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë diplomë, CV si dhe Certifikatat e leshuara nga nje organ i akredituar per certifikim personeli.*
- iv. Per personin pergjegjes/koordinatorin HSE, Certifikatën përkatëse të leshuar ngainstitucioni kompetent.*

Për përmbushjen e këtij kriteri,operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikat 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar natyres se shërbimeve që prokurohen sqarojmë se stafi teknik i kualifikuar profesionalisht është kërkuar ne raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë elektrike, mekanike etj. në tubacionin e gazit që ka një presion operimi prej 95 Bar, përfshirë edhe stacionet e valvulave dhe kompresorëve, ndaj AGSco e sheh të domosdoshme që për funksionimin e sigurt të këtyre impianteve, për të ruajtur standardet e sigurisë së funksionimit dhe sigurinë e punonjësve që operojnë dhe mirëmbajnë këto impiante është d.m.d gatishmëria e personelit të kualifikuar të operatorit ekonomik fitues.

Prandaj, inspektimet rregullatore shërbejnë për të përmbushur kuadrin rregullator shqiptarë dhe gjithashtu inspektimet që bëhen me kërkesë të TAP janë pjesë integrale për të kontrolluar rreziqet e punës në tubacion dhe funksionimin e sigurt. Siç u tha më lart për të siguruar funksionimin e sigurt në përputhje me standardet ndërkombëtare, inspektimet duhet të kryhen për të siguruar integritetin e tubacionit dhe impianteve të tjerë të lidhur.

Pjesë e inspektimeve për garantimin e sigurisë teknike të impianteve të TAP do të jete edhe Testimi NDT (pa shkatërrim) që do të përfshijë inspektimin e saldimeve të reja të prodhimit ose riparimit të saldimeve. Gjithashtu, për strukturat ekzistuese, këto teste do të përdoren për të parashikuar ose vlerësuar jetën e shërbimit të eneve (rezervuarë, ndarës, filtra, tubacione etj.) Në stacionet ose stacionet e valvulave bllokuese.

Për të kryer këto lloje inspektimi të detajuar në specifikimet teknike, personeli duhet të jete i kualifikuar dhe certifikuar për metodat NDT të përmendura më poshtë.

Referuar Standardit SSH EN ISO 16810:2012 “Prova pa shkatërrim - Prova me ultratinguj - Parime të përgjithshme”, kapitulli për kualifikimin e personelit kërkon: “Ekzaminimi duhet të kryhet nga personel i kualifikuar në përputhje me SSH EN ISO 9712”. Për këtë është kërkuar që inspektori i cili do të kryej matjet e spesorit me ultratinguj të jete i kualifikuar sipas këtij standardi. Pra, 1 (nje) inspektor NDT të Çertifikuar për RT / PT / MT / VT / UT - Niveli II

Ndërsa për të kryer inspektimin e përmendur në specifikime teknike dhe termat e referencës dhe konkretisht metodën me rreze X të NDT (testimeve pa shkatërrim), sipas VKM Nr.10 date 7.1.2010 “Për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”, duhet të jete një person i kualifikuar në fushën e radiombrojtjes, i çertifikuar për sigurinë e rrezatimit

Gjithashtu për shkak se tubacioni është përhapur në të gjithë territorin shqiptar (215 km) dhe vendet në zona shumë të largëta, gjithashtu për shkak të numrit të madh të impianteve të vendosura në vende të ndryshme (9 stacione valvulash, 1 stacion matje dhe një stacion kompresorësh), për të kryer inspektimet sipas specifikimeve teknike, kërkohet numri minimal prej 6 punonjës (inxhinierë). Inspektimet mund të bëhen në të njëjtën kohë në shumë stacione të valvulave

gjithashtu në stacionin e kompresorit dhe matjes dhe numri minimal i grupeve të punës do të jete jo më pak se dy persona.

2.2.8 Operatori i ekonomik duhet të dorëzojë Akt-Miratimin “Organ i miratuar për vlerësimin e konformitetit” Tipi OMVK: TIPI A”, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për fushat e veprimtarisë si më poshtë:

- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të enëve nën presion.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të valvulave të sigurisë të presionit
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të Instalimeve Elektrike
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të makinerive ngritëse dhe aksesorëve.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të shkallëve dhe platformave
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të instalimeve ATEX.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të ashensorëve.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të litereve së sigurisë për punimet në lartësi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij Akti-Miratimi kërkohet të realizohen shërbime profesionale në Nënkatëgorinë A. Ky kriter bazohet gjithashtu edhe në kërkesat e Ligjit nr. 10489/2011 i ndryshuar “Për mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, ku në Nenin 16 “Detyrimet e personit përgjegjës të produktit/instalimit në shërbim”, pika 1, 2 dhe 3 përcaktohet shprehimisht se:

1. *Personi përgjegjës i produktit/instalimit ka detyrimin të garantojë se produkti/instalimi i vënë në shërbim/në përdorim për të tretët apo publikun e gjerë vazhdon të jetë në përputhshmëri me kërkesat e sigurisë së produktit/instalimit të vënë në shërbim gjatë gjithë periudhës së tij të përdorimit.*
2. *Personi përgjegjës i produktit/instalimit është, gjithashtu, i detyruar të regjistrojë produktin/instalimin dhe t’ia nënshtrijë atë inspektimit të rregullt periodik të kryer nga organet e miratuara kompetente për këtë qëllim.*
3. *Regjistrimi kryhet pranë strukturës përgjegjëse, ndërsa inspektimi periodik kryhet nga organi i miratuar, në bazë të kërkesës së personit përgjegjës dhe me shpenzimet e tij.*

Nderkohe po ky ligj përcakton se vetëm subjektet e akredituar mund të përfitojnë statusin si “Organ i miratuar” të dhene nga Ministria përgjegjëse, dhe si të tillë vetëm këta.

2.2.9 Operatori i ekonomik duhet të zotërojë Licencë “Për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues” të lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes së Rrezatimit sipas legjisllacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Bazuar në termat e referencës dhe specifikimet

teknike, kategoria B pika 3, OE do duhet te kryej Testime pa shkaterrim te strukturave metalike dhe saldimeve (NDT). Testime me radografi permban paisje qe perdorin rrezatime jonizuese, prandaj OE ne perputhje me Ligjin Nr.8025, date 9.11.1995 "Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar dhe VKM Nr.10 date 7.1.2010 "Per miratimin e rregullores "Per licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimeve jonizuese", duhet te jete i pajisur me "Licencë për aktivitet me burime rrezatimi jonizues - Njohur nga Autoritetet Shqiptare".

2.2.10 Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të vetëdeklarojë se nëse do të shpallet fitues do vëre ne dispozicion te AK para se të nënshkruaj kontratën dhe planin zbatimit të saj, dokumentat e meposhteme: Planin e sigurise dhe shendetit ne pune pefshire vleresimin e rrezikut

- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per dhenien e ndihmes se shpejte
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per sigurine e paisjeve elektrike
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per sigurine e eneve ne presion
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per zonen ATEX
- Certifikatë e aftë për punë, e nënshkruar nga mjeku i punës
- Metodologjite e inspektimit per proceset e inspektimit te pershkruara ne kategorite A dhe B te specifikimeve teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe ne nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Bazuar ne termat e references dhe specifikimet teknike operatorët ekonomike duhet të provojnë disponimin e ketyre dokumenteve , te cilat janë të domosdoshme per te garantuar aksesin dhe realizimin e kontrates me sukses ne ambientet e TAP.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.11 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin

e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favorët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.